

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklarata e Ramës për Vlora Hysenin/ Bushati: Gjuha e dyfishtë tregon se Rama ishte në ngërç
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/deklarata-e-rames-per-vlora-hysenin-bushati-gjuha-e-dyfish-te-tregon-s-i474940
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:07:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 19:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0e95b0ceafe4e163ae308c7c57a3d68f444183fd6b52ceffb9731f2ac1298e52
TEKSTI	db7e36e32cad464f59dc4846a9be2fcc0c677dd258357292080ae5cd5391d3da
PAMJA	5a783a9c1d401d5548bdebafa4a8a762dd53aa34aef100cd8be8bddf459c8b03

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	53496a00622733029041b4f7c938e2f3955d7001ed674fcc7cf375a09cc7a07d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/53496a00622733029041b4f7c938e2f3955d7001ed674fcc7cf375a09cc7a07d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Deklarata e Ramës për Vlora Hysenin/ Bushati: Gjuha e dyfishtë tregon se Rama ishte në ngërç



22 Shtator 2026, 21:54, Aktualitet CNA



Gazetari dhe analisti Andi Bushati ka folur lidhur me aksionin e sotëm të SPAK dhe caktimin e masave të sigurisë ndaj Vlora Hysenit, e cila u shkarkua nga detyra si drejtoreshë e SHISH mbremjen e sotme.

I ftuar në Syri Tv, Bushati u shpreh se aksuh nuk e priste që të arrihej deri në këtë pikë. Ai shtoi më tej se kjo është nga herët e para që sipas tij SPAK-u vepron dhe nuk rrjedh informacion për gazetarët. Bushati e cilësoi si gjuhë të dyfishtë deklaratën e kryeministrit Edi Rama për Hysenin.

“Përflitej shumë po askush nuk e priste që të arrihej deri këtu. Pra, dihej që përflitej, diheshin lidhjet, diheshin të gjitha. Edhe Proda dihej, edhe Vlora Hyseni. Problemi është që ne akoma tani kemi shumë pak informacion. Është nga herët e para që SPAK-u vepron dhe nuk rrjedhin informacione për gazetarët e SPAK-ut e të tjera e të tjera. Pra dimë që kjo zonja ka nxjerrë sekretin shtetëror dhe ka mbrojtur këta banditët. Dhe këtu pastaj, kaq dihet si fakte, këtu jemi në rrafshin e hipotezave dhe hipotezat që ngrihen tani.

Pra, ti ngrite dy pyetje. E para a e dinte, a ishte i përfshirë Edi Rama, dhe e dyta a mund të bëhet kjo pa aleatët tanë, pa amerikanët kryesisht. E

para, nga mënyra si reagoi sot Edi Rama, me vonesë, me një gjuhë të dyfishtë... domethënë, një njeri që akuzohet, minimumi akuzohet, se ka nxjerrë sekretet shtetërore dhe ka bashkëpunuar me kriminelë, mundet kryeministri i një vendi ta falënderojë? E pastaj pasi ta falënderojë për arritjet e mëdha që ka pasur në SHISH, edhe të thotë që ajo ka fajet e saj personale dhe mëkatet e asaj nuk e dëmtojnë qeverinë.


Pra çfarë tregonte kjo gjuhë e dyfishtë? Kjo gjuhë e dyfishtë tregonte që Rama ishte në ngërç. Ishte në një ngërç me atë që edhe nuk do të njësohet me bandën e Ergys Agasit, se po ta mbrojtë publikisht, njësohet, por dhe nuk do ta hedhi poshtë se di që pozicioni i asaj zonjës ka ca dosje që mund t'i prishin punë. Prandaj bën deklaratatë tilla që s'janë as mish as peshk. Dhe prandaj detyrohet, gënjej, që unë e mora vesh më vonë se jam në New York", tha Bushati.

Ndër të tjera, gazetari tha se kryeministri Edi Rama ishte në dijeni në arrestimit të drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, ndaj për këtë arsye ka krijuar alibinë e tij.

"Ndërkohë, që po të hapësh intervistën e Ramës tek kolegja jonë Rudina Xhunga, ai gati ka bërë alibinë që unë s'kam pasur lidhje me Vlora Hysenin sepse thotë, të gjithë bota e di që unë raportet e SHIK-ut, e tha në SHIK unë i jap besim, i lexon vetëm shefja ime e kabinetit, unë s'di gjë. Pra, ai e ka ditur shumë mirë ç'do ndodhi më pas, por bëri të paditurin. Dhe kjo tregon, kjo tregon që Rama ka një ngërç me këtë punë.

Rama padyshim ka qenë në dijeni, ka bërë dy javë përpara alibinë. Nuk mundet, nuk mundet, jo ky shteti jonë që është shtet banditesk, po as në shtete serioze, të arrestohet shefja e shërbimit inteligjent, kryeministri detyrimisht lajmërohet. Nuk ndodh në asnjë vend. Jo më këtu që këta e kanë të gjithë shtetin të vetin. Pra, padyshim Rama e ka ditur, po këtë e provon dhe fakti që Rama dy javë, në gjashtë shtator, ka bërë alibinë, unë s'e di çfarë bënte, unë i kam dhënë besim të plotë, vetëm shefja ime e kabinetit e kontrollonte.

E dyta, dhe kjo e shton pastaj misterin, është pyetja jote e dytë. A bëhet kjo pa amerikanët? Ne mbajmë mend, kur Sali Berisha donte të shkarkonte shefin e SHIK-ut, u bë nami. U bë nami si mund ta shkarkosh ti që e kishte kompetencë të vetën, pa pyetur aleatët. Këtu nuk bëhet më fjalë për shkarkim, po këtu bëhet fjalë edhe për arrestim, dhe askush nuk foli. Pra, a kemi diçka aq të rëndë sa edhe partnerët, se SHIK-u dihet që kontrollohet nga amerikanët, e kanë lëshuar? Dhe a shkon kjo përtej Vlora Hysenit? Këto janë pyetjet që në mungesën e fakteve bazë, po me logjikë dhe duke njohur kuadrin e madh, janë pyetjet më themelore sot, mendoj unë", tha Bushati. /CNA





Të sugjeruara

Kërkohet dorëheqja e Ramës/ Sot protesta e 115 kundër qeverisë

Përgjimet e Agasit, një thesar në duart e SPAK

GJKKO i caktoi masë sigurie/ Vetëdorëzohet Vlora Hyseni

Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit

EKSKLUZIVE/ Deputetë e zyrtarë të lartë, komunikime dhe takime intensive me Ergys Agasin

Nga Asim Vokshi te Naureda Llagami/ Të gjitha fijet që të çojnë te Erion Veliaj

Kur Berat Buzhala del si budalla

GJKKO revokon sekuestron e pasurive të ish-gjyqtarit

Edi Rama mund ta turpërojë edhe më shumë Shqipërinë

Gazetari: Vlora Hyseni e ka mbyllur ciklin e karrierës, sinops për dokumentar

Industria e gjobëvënies/ Nikolin Jaka: Bizneset përballen me humbje serioze financiare

Mbledhja e FBINAA-së/ Ambasada e SHBA-së: Qëllimi i vetëm është zbatimi i fortë i ligjit

Sekuestrohet hoteli 5-katësh pa leje në Ksamil, 1 shtetas në arrest shtëpie

Sulmet e mediave anonime/ Dhoma e Tregtisë: Të zbatohen masat që mbrojnë biznesin

Masa e sigurisë për Vlora Hysenin/ Rama e liron nga detyra si kryetare e SHISH

Gjyqësori në mediet dhe gazetarinë/ Nikolin Jaka: Bizneset përballen me humbje serioze financiare

Shpërvendja nga media dhe portalet anonime/ Liridon Jaka: E v shtetshme dhe demokraci qendroren qendroren qendroren

Projektligji i ri krijon hapësirën e posaçme ligjore për emetimin e obligacioneve të mbuluara

Kikia: Ngjarje fatale, zyrtarët e inkriminuar kanë ngrënë kokën e shtetit

Masa ndaj Hysenit/ Xhafaj, si Spiropali: Ndodh rëndom në botë


Operacioni i SPAK-ut/ Kontrolle në kompleksin e vilave në Shkozë

[editorial](#)

16:30 Editorial

Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni: Harta e një shteti që po shpërbëhet

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

22:05 Opinione Luan Rama

Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit

21:14 Opinione Filip Çakulli

Tani i Madh, Topi i Madh

10:01 Opinione Ardi Stefa

Patriotët selektivë të patriotizmit selektiv

Lifestyle

14:00 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.